

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA ELGAKOTI SHPK DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 63986/10 dhe 5 të tjerë – shih listën bashkëlidhur)

VENDIM STRASBURG

6 Korrik 2023

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Elgakoti sh.p.k. kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur si një Komision, i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e Përkohshme e Seksionit,*

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 15 qershor 2023;

Jep vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja nisi me kërkesat kundër Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (“Konventa”) në data të ndryshme të paraqitura në tabelën bashkëlidhur.

2. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u njoftua për kërkesat.

FAKTET

3. Lista e kërkesave dhe detajet përkatëse të kërkesave janë paraqitur në tabelën bashkëlidhur.

4. Kërkuesit u ankuan për mosekzekutimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendëse. Disa kërkues paraqitën edhe ankesa të tjera në mbështetje të praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës.

LIGJI

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

5. Duke pasur parasysh lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata e konsideron me vend që t’i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

II. POZITA E TRASHËGIMTAREVE TË KËRKUESIT PËR TË NDJEKUR KËRKESËN NR. 45719/12

6. Më 4 maj 2015, Gjykata u informua se z. Kulo, kërkuesi në kërkesën nr. 45719/12, kishte ndërruar jetë dhe se gjykata vendëse kishte caktuar si trashëgimtarë znj. Anila Kulo, Ermioni Kulo dhe Elina Kulo, ku secila prej tyre merrte 1/3 e të drejtave dhe detyrimeve të tij.

7. Gjykata gjykon se trashëgimtarët e kërkuesit kanë interes legjitim në zënien e vendit të kërkuesit (shih *Dalban kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28114/95, §§ 1 dhe 39, GJEDNJ 1999 VI, dhe *Ernestina Zullo kundër Italisë* [DHM], nr. 64897/01, § 37, 29 mars 2006).

8. Rrjedhimisht, Gjykata vendos se znj. Anila Kulo, Ermioni Kulo dhe Elina Kulo kanë pozitat të vijnë procesin konkret. Megjithatë, Gjykata do t'i referohet, sidoqoftë, z. Kulo si kërkuar në vendimin konkret.

III. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

9. Kërkuarit u ankuan kryesisht për mosëkzekutimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendëse të dhëna në favor të tyre. Ato u mbështetën, shprehimisht ose në substancë, në nenin 6 § 1 të Konventës.

10. Gjykata përsërit se ekzekutimi i vendimit dhënë nga cilado gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e një “gjykimi” për qëllime të nenit 6. Gjithashtu, ajo i referohet praktikës së saj gjyqësore në lidhje me mosëkzekutimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendëse të formës së prerë (shih *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, § 40, *Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve* 1997-II).

11. Në çështjet kryesore, *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, 18 nëntor 2004, dhe *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 shtator 2009, Gjykata kishte konstatuar një shkelje për problematika të ngjashme me ato në çështjen konkrete.

12. Pasi shqyrtoi të gjithë materialin e depozituar pranë saj, Gjykata nuk ka konstatuar asnjë fakt ose argument që ta bindë të arrijë një përfundim të ndryshëm për pranueshmërinë dhe meritat e ankesave të mësipërme. Duke pasur në konsideratë praktikën e saj gjyqësore për subjektin, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete autoritetet nuk bënë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të ekzekutuar plotësisht dhe në kohë vendimet në favor të kërkuarve.

13. Për këto arsye, këto ankesa janë të pranueshme dhe përbëjnë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

IV. PRETENDIME TË TJERA PËR SHKELJE SIPAS PRAKTIKËS GJYQËSORE TË KONSOLIDUAR

14. Edhe kërkuarit në kërkesat nr. 63986/10, 11487/11, 48963/11, 45720/12 dhe 71642/12 u ankuan në mbështetje të nenit 13 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 për mosëkzekutimin dhe ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendëse dhënë në favor të tyre. Duke pasur në konsideratë faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe gjetjet e saj përmendur më sipër, Gjykata vlerëson se ka shqyrtuar çështjen kryesore ligjore në kërkesat konkrete. Në këtë mënyrë, ajo konstaton se ankesat e tjera të kërkuarve janë të pranueshme, por se nuk është e nevojshme që të japë një vendim të veçantë për to (shih *Qendrën për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, HJEDNJ 2014, dhe *Habilaj kundër Shqipërisë* [Komisioni], nr. 2480/10, § 14, 15 shtator 2022).

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

15. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërbtim të drejtë palës së dëmtuar.”

16. Duke pasur në konsideratë dokumentet në zotërimin e saj dhe praktikën e saj gjyqësore (shih, veçanërisht, *Qudaj Co. sh.p.k.*, cituar më sipër, §§ 46–48, dhe *Gjyli*, gjithashtu cituar më sipër, §§ 62–76), Gjykata e vlerëson të arsyeshme të akordojë shumat e paraqitura në tabelën bashkëlidhur.

17. Në lidhje me kërkesën nr. 11487/11, kërkuar pretendoi se nga momenti i përfundimit të kontratës e deri në rikthimin e tij, paga e tij ishte rritur, por atij nuk i ishte paguar indeksimi i pagës. Ai kërkoj që t'i paguhej indeksimi i pagës së tij për disa vjet. Vendimi i formës së prerë i gjykatës nuk përshkruan ndonjë shumë mbi të cilën duhet të llogaritet paga e tij, megjithatë, Gjykata vlerëson se nëse kërkuar do të ishte rikthyer në pozicionin e tij në kohë, siç urdhëronte vendimi, ai do të kishte pasur të drejtën ta merrte të plotë pagën, dhe indeksimi i pagës së tij duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e gjykimit të gjykatave vendëse. Në vijim, kjo qasje mbështetet nga dispozitat vendëse

të Kodit të Punës, sipas Nenit 120, sipas së cilit punonjësit kanë të drejtën të përfitojnë automatikisht nga indeksimi. Debitori në procedurat e ekzekutimit, që do të thotë autoritetet në çështjen konkrete, kontestoi shumat që duhet të paguheshin (shih *Memishaj kundër Shqipërisë* [Komisioni], nr. 40430/08, § 39, 25.3.2014).

18. Kërkuesi në kërkesën nr. 71642/12 parashtroi se autoritetet nuk i kishin paguar as kontributet shëndetësore dhe shoqërore, të cilat i jepnin të drejtën për pensionin nga mosha, si edhe nuk i kishin paguar as interesin e përllogaritur mbi këtë shumë. Për sa u përket pretendimeve për kontributet shëndetësore dhe shoqërore, Gjykata vlerëson se punëdhënësi është i vetmi në pozicionin për të paguar kontributet për sigurimet shëndetësore dhe fondet e pensionit sipas pagave të detyrueshme për t'u paguar në momentin kur i kishte paguar kërkuesit detyrimet për pagat; për këtë arsye, këto kontribute duhet të konsiderohen si një pjesë integrale e gjyqimit të gjykatave vendëse, dhe i takon Qeverisë të marrë masat e nevojshme për këtë aspekt (shih *Miclici kundër Rumanisë*, nr. 23657/03, §§ 66–67, 20 dhjetor 2007).

19. Gjithashtu, Shteti duhet të garantojë, me anë të mjeteve të duhura, ekzekutimin e vendimeve vendëse që janë pezull, referuar në tabelën bashkëlidhur.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *Vendos* t'i bashkojë kërkesat;

2. *Deklaron* se znj. Anila Kulo, Ermioni Kulo dhe Elina Kulo kanë pozitën të vijnë procesin në emër të të ndjerit z. Kulo, kërkuesi në kërkesën nr. 45719/12;

3. *I deklaron* ankesat në lidhje me mosekzekutimin dhe ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendëse sipas nenit 6 të Konventës, të pranueshme, dhe *vendos* se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pjesa tjetër e ankesave në aplikimet nr. 63986/10, 11487/11, 48963/11, 45720/12 dhe 71642/12;

4. *Gjykon* se kërkesat konstatojnë një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me mosekzekutimin dhe ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendëse;

5. *Gjykon* se Shteti përgjegjës duhet të sigurojë, me anë të mjeteve të duhura, brenda tre muajve, ekzekutimin e vendimeve vendëse referuar në tabelën bashkëlidhur, duke marrë në konsideratë edhe gjetjet e Gjykatës në paragrafët 17 dhe 18 më sipër;

6. *Gjykon*:

a) se Shteti përgjegjës duhet t'u paguajë kërkuesve, brenda tre muajve, shumat e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur, të konvertuara në monedhën e Shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se nga përfundimi i tre muajve përmendur më sipër deri në shlyerje, për shumat e mësipërme duhet të paguhet interes i thjeshtë në normën e barabartë me normën marginale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonësës së pagesës plus tre për qind pikë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 6 korrik 2023, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSREGJISTRAR I PËRKOHSHËM

Ioannis Ktistakis
KRYETAR

SHTOJCË
LISTA E KËRKUESVE QË PARAQESIN ANKESAT NË MBËSHTETJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS
(MOSEKZEKUTIM OSE EKZEKUTIM I VONUAR I VENDIMEVE VENDËSE)

Nr.	Kërkesa nr. Data e dorëzimit	Emri i kërkesit Viti i lindjes/ regjistrimit	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Vendimi përkatës vendës	Data e nisjes së periudhës së mosekzekutimit Kohëzgjatja e procesit të ekzekutimit	Data e përfundimit të periudhës së mosekzekutimit Kohëzgjatja e procesit të ekzekutimit	Akordimi vendës (në euro)	Detaje të urdhrit të ekzekutimit	Shuma e akorduar për dëm jo pasuror për kërkuar (në euro)	Shuma akorduar për kostot dhe shpenzimet për kërkesë (në euro) ¹
1	63986/10 9.10.2010	EGLAKOTI SHPK 1994	Ibra Bardhyl Elbasan	Gjykata e Apelit Vlorë, 22.6.1999	25.2.2000	Pezull Më shumë se 22 vjet dhe 8 muaj	Gjykata e Apelit Vlorë, 22.6.1999 urdhëroi Drejtorinë e Shërbimeve Shëndetësore t'i paguante kompanisë kërkuar shumën në total prej 3,130,600 lekësh	Gjykata e Rrethit Vlorë, nr. 173 9.9.1999	2,500	-
2	11487/11 16.2.2011	Arben CARCIU 1961	Kokona Elira Tiranë	Komisioni i Shërbimeve Civile, 16.6.2006	18.1.2008	Ekzekutuar pjesërisht më 15.1.2015 për sa i përket rikthimit në pozicion dhe shlyerjes së pagave të vonuara 6 vjet dhe 11 muaj dhe 29 ditë	Vendim i Komisionit të Shërbimeve Civile nr. 456, datë 16.6.2006, urdhëroi heqjen e masës disiplinore zbatuar ndaj kërkuar; rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm dhe pagesën e pagave të vonuara deri në rikthim.	Gjykata e Rrethit Tiranë, nr. 18, 18.2.2011	3,600	250
3	48963/11 26.7.2011	Edipe SHKËMBI 1955		Gjykata e Rrethit Tiranë, 6.6.2005	20.6.2005	31.3.2015 8 vjet dhe 9 muaj, dhe 12 ditë (ekzekutuar pjesërisht në korrik 2007; kërkuar arriti moshën e daljes në	Vendim i Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 1368 i datës 6.6.2005, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë më 20.6.2006, që	Gjykata e Rrethit Tiranë, nr. 419, 5.2.2009	4,700	-

¹ Plus çdo taksë që mund t'u tarifohet kërkuar.

						pension në vitin 2015)	urdhëroi punëdhënësin e kërkujeses, Transmetuesin Publik Shqiptar, ta rikthente në detyrë dhe t'i paguante kërkujeses shpërblimin në shumën në total prej 552,500 lekësh si rezultat shkarkimit të padrejtë nga detyra			
4	45719/12 13.7.2012	Harallamb KULO Lindur në vitin 1945 Vdekur në vitin 2012 Trashëgimtarë Ermioni Kulo Anila Kulo Elina Kulo		Komisioni i Shërbimeve Civile, 12.7.2006	31.3.2008	26.1.2016 7 vjet dhe 9 muaj, dhe 27 ditë	Komisioni i Shërbimeve Civile, më 12.7.2006, urdhëroi ndryshimin e masës disiplinore për shkarkimin e kërkujesit dhe e zëvendësoi me një masë më të lehtë. Në vijim, ai urdhëroi rikthimin e kërkujesit bë pozicionin e mëparshëm dhe shlyerjen e pagave të vonuara deri në rikthimin në pozicion. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë më 31.3.2008.	Gjykata e Apelit Tiranë, 31.3.2008	3,600 duhet t'u paguhen trashëgimtareve së bashku	-
5	45720/12 9.7.2012	Fisnik BROVINA 1964		Gjykata e Apelit Tiranë, 13.9.2011	8.3.2012	Pezull për më shumë se 11 vjet dhe 1 muaj, dhe 7 ditë	Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 1789, i datës	Gjykata e Rrethit Tiranë, nr. 5544,	4,700	-

							13.9.2011, urdhëroi anulimin e akteve për shkarkimin e kërkuesit nga pozicioni i tij, rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm, dhe shlyerjen e pagave të vonuara deri në rikthimin në detyrë. Gjithashtu, u urdhërua punëdhënësi i kërkuesit që t'i paguante diferencën midis pagës së Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit dhe pagës së kërkuesit për dy muaj.	18.10.2011		
6	71642/12 3.11.2012	Sotirag GJATA 1953		Gjykata e Rrethit Tiranë, 30.11.2006	19.2.2008	Ekzekutuar pjesërisht më 19.12.2018 10 vjet dhe 10 muaj, dhe 1 ditë	Vendim i Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 6807, i datës 30.11.2006, lënë në fuqi nga vendimi i Gjykatës së Apelit nr. 1396 i datës 16.11.2007, urdhëronte anulimin e urdhrit për shkarkimin e kërkuesit, rikthimin e tij në detyrën e mëparshme dhe shlyerjen e	Gjykata e Rrethit Tiranë, nr. 432, 19.2.2008	4,700	-

							pagave të vonuara, sipas pagës së tij mujore në shumën prej 36,789 lekësh deri në rikthimin në detyrë			
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--